



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Date \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**Shtojca 14**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

01.07.2021

Për: Operatorin Ekonomik “DRINI A” Shpk, me NUIS J67902505V, me adrese Lagjja “Nen Tereza”, godina ne rrugen nacionale Lezhe - Shkoder km I, ne zonen kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1 volum 24 faqe 225, Lezhe.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: E Hapur/ Mallra

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-95880-05-19-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale per mirembatjen e Ndiriçimit Rrugor ne Qytetin e Lezhes”

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes – Kuader.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Operatori Ekonomik “DRINI A” Shpk me Nuis J67902505V, me ofertë ekonomike **19,073,940** (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e tre mije e nëntëqind e dyzet) Lek pa Tvsh dhe me shumatore te çmimeve per njësi prej **79,885** (shtatëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e tetëdhjete e pese) Lek pa Tvsh.
- Operatori Ekonomik “HEST” Shpk, me Nuis L21527009H, me ofertë ekonomike **16,921,110** (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e njëzet e nje mije njëqind e dhjete) Lek pa Tvsh dhe me

shumatore te çmimeve per njësi prej **109,896** (njëqind e nente mije e tetëqind e nentedhjetë e gjashtë) Lek pa Tvsh.

- Operatori Ekonomik “STELLA” Shpk, me Nuis J87603505T, me ofertë ekonomike **19,158,275** (nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e tete mije e dyqind e shtatëdhjetë e pese) Lek pa Tvsh dhe me shumatore te çmimeve per njësi prej **122,715** (njëqind e njëzet e dy mije e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) Lek pa Tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori Ekonomik “HEST” Shpk, me Nuis L21527009H
- Operatori Ekonomik “STELLA” Shpk, me Nuis J87603505T

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- **Operatori Ekonomik “HEST” Shpk, me Nuis L21527009H**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson piken 1, te kriterëve te vecanta te kualifikimit, pasi:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

*b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;*

*ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*

*d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

*dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;*

nuk jane paraqitur sipas formatit te kerkuar ne DST per dokumentacionin e mesiperm. Bejme me dije se formati i duhur per dokumentacionin e mesiperm eshte publikuar nga AK ne DST.

Se dyti, nuk ploteson piken 2.3.7 te DST, ne te cilen kerkohet: Ditën dhe oren e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

Automat monofaze 32 A
Koka ndriçusi Led
Leshues magnetik 80A
Leshues magnetik 100A
Salvavita 63A 3 Fazor
Salvavita 100A 3 Fazor
Finter rrugor 16A (4hyrje)

- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Drejtorise se shërbimeve Publike, se bashkë me adresë: Rruga Vellezrit Coku, Ish SMT, Lezhe.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

Bazuar edhe në procesverbalin Nr. 01, datë 30.06.2021, i mbajtur midis Komisionit të Vleresimit të ofertave dhe Operatoreve Ekonomik të pranishëm gjatë zhvillimit të procedurës për dorezimin e mostrave ditën dhe orën e hapjes së ofertave, Operatori Ekonomik “**HEST**” Shpk, nuk është paraqitur për të dorezuar mostrat për artikujt e kërkuar në DST.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nënën 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nënën 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “**HEST**” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “**HEST**” Shpk, *skualifikohet*.

**- Operatori Ekonomik “STELLA” Shpk, me NUIS J87603505T.**

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Nuk plotëson të paktën 1, të kriterëve të vecanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertes të kërkuar në DST.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “STELLA” Shpk, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “STELLA” Shpk, *skualifikohet*.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “DRINI A” Shpk, me NUIS J67902505V, me adresë Lagjia “Nen Tereza”, godina në rrugën nacionale Lezhe - Shkoder km I, në zonën kadastrale 8632, me nr. pasurie 13/55-1 volum 24 faqe 225, Lezhe, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **19,073,940** (nëntëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet) Lek pa Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit dhe dokumentacionin e ofertes tuaj të noterizuar, brenda 10 (dhjete) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera

*përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.*

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.07.2021

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

**TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**K R Y E T A R I**  
**Pjerin NDREU**

**SHENIM PER APP-ne**

**Bejme me dije se KPP, ka miratuar lejimin e vazhdimit te procedures me Vendim Nr. 347/2021.**